

Fjala e nënkryetares së Akademisë, akademike Justina Shiroka-Pula, në mbledhjen komemorativë për Luan Mulliqin

E nderuar familje e Akademik Luan Mulliqi,

Të nderuar anëtarë të Akademisë, të afërm, miq, kolegë, shokë e bashkëpunëtorë të Luan Mulliqit. Jemi tubuar sot, në këtë komemoracion, për të nderuar figurën dhe veprën e profesorit, intelektualit, artistit dhe krijuesit të shquar të Kosovës, Akademik Luan Mulliqi.

Në këto momente dhembje e pikëllimi të thellë të familjes Mulliqi që e humbi njeriun e tyre të dashur, kolegët dhe personeli i këtij Institucioni humbëm mikun e çmuar, ndërsa miqtë e shumtë në Kosovë, sot ndien një pikëllim të thellë për këtë humbje, i cili do të mbetet në kujtesën tonë si pedagog i shumë brezave, intelektual, artistë bashkëkohor i kohës moderne, krijues e skulptor i madh i artit shqiptar dhe më gjerë.

Luan Mulliqi (1953), lindi në Gjakovë. Studimet për skulpturë i kreu në Akademinë e Arteve Figurative të Universitetit të Prishtinës (1977), ndërsa studimet pasuniversitare në Fakultetin e Arteve në Beograd (1979).

Që nga viti 1977 është anëtar i SHAFK (Shoqata e Artistëve Figurativë të Kosovës) si dhe anëtar i SHA të Çikagos, SHBA (1990), ndërsa në vitin 1992 pranohet anëtar i “Qendra Ndërkombëtare e Skulpturës” në Nju Jork të SHBA-ve, si dhe anëtar i rregullt i “Qendra Ndërkombëtare e Skulpturës në Uashington (1994).

Ka marrë pjesë në simpoziume të skulpturës me karakter ndërkombëtar si dhe ka botuar shumë shkrime për skulpturën monumentale. Ka përgatitur dhe botuar dy monografi për artin pamor në Kosovë.

Për jetën dhe krijimtarinë e tij të begatshme janë shkruar shumë artikuj në mediat e shkruara dhe ato digjitale, është i pranishëm në shumë katalogë e monografi.

Ka realizuar projekte skulpturale të artit publik në SHBA, Kosovë dhe në Shqipëri. Për shumë vite punoi ligjërues në Universitetin e Prishtinës dhe Universitetin e Tetovës.

Për afro dhjetë vite ishte drejtor i Galerisë Kombëtare të Kosovës, ndërsa prej vitit 2012 pranohet anëtar korrespondent në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Ishte sekretar i seksionit të arteve në Akademi deri në vitin 2021, ndërsa nga viti 2022, realizoj të gjitha detyrat me përkushtim si sekretar shkencor në ASHAK.

Miq e dashamirë të Mulliqit , krijimtaria krijuese artistike e tij gjenden në disa galeri e muze, ndërsa skulptura “Hyjnesha” është pjesë e koleksionit të përhershëm të Muzeut Kombëtar të Francës.

Veprat e tij gjinden gjithashtu te koleksionistë privatë dhe personalitete të njohura, siç janë: Papa Gjon Pali II, presidenti Clinton, mbreti Hirohito, mbretëresha Elizabeth II, princesha Diana, presidenti G. Bush, Papa Benedikti XVI, presidenti Demirel, presidenti Berisha, etj.

Mulliqi, veprimtarin artistike e filloji që nga viti 1977, dhe deri më sot ka realizuar më shumë se 12 ekspozita personale dhe mbi 15 ekspozita kolektive me rëndësi. Ekspozitën e parë personale e realizojë në vitin 1979 në Galerinë e Fakultetit të Arteve , Beograd. Ndërsa në vitet 1992, 1994, 1995 ekspozojë në Chikago, Dallas dhe Nju Jork të SHBA . Krijimtaria e Mulliqit vazhdoj të jetë prezente me ekspozita edhe në vitin 2008 Prishtinë, 2012 Austri, 2014 Rumani, 2015 Paris (ku ekspozohen në mënyrë ekskluzive skulptura “Hyjnesha”), 2016 dhe 2020 në Prishtinë, 2018 Prizren dhe 2022 në Shkup.

Ndërsa nga Ekspozitat kolektive me rëndësi, do ta theksojmë ato të vitit 1977 Dubrovnik- Kroaci /1992 Amsterdam-Holande/ 1993 Japoni/ 1994 Itali/ 1995 dhe 1997 në SHBA/ 2000 Tiranë/ 2003 Gjermani/2004 Indi dhe 2007 Paris.

Duhet veçuar disa nga monumentet artistike të realizuara nga skulptori Mulliqi, me të cilat ai dhe të gjithë ne krenohemi janë:

2006 – Shtatorja e akademik Fehmi Agani, Prishtinë /2007 – Shtatorja e Nënë Terezës, Aeroporti i Tiranës / 2014 – Sheshi “Ali Podrimja”, Gjakovë / 2014 – Sheshi i Dëshmorëve, Pejë / 2015 – Shtatorja e Ismail Qemalit, Prishtinë / 2018 – Busti i Sekretares së shtetit të SHBA-ve Medlin Ollbrajt në Prishtinë / 2019 – Skulptura e senatorit Bob Dole në Prishtinë / 2020 – Monumenti “Hasjanja”, Prishtinë.

Ishte kjo krijimtaria artistike, përkushtimi dhe angazhimet e suksesshme të profesorit Mulliqi i cili la një trashëgimi shumë të vlefshme të veprimtarisë artistike- në drejtim të skulpturës dhe shtatoreve, që u bën pjesë e rëndësishme në jetën tonë shoqërore në Kosovë.

Ai na la gjithashtu trashëgimi “ Muzeun e parkut nacional të skulpturës”(është në pronësi të familjes), që është kopsht i veprave sipas vizionit të krijuesit, një testament prej 180 skulpturash autoktone shqiptare të shkruara në BRONZ, të dedikuara Kosovës dhe historisë.

Me këtë krijimtari ai prezantoi artin bash kohor në kohën moderne, duke lënë gjurmë të forta, dhe kështu gdhendi emrin e tij përjetësisht.

Akademik Mulliqi për punën e tij madhore është vlerësuar nga rrethet profesionale në Kosovë dhe jashtë saj, me shumë mirënjohje e shpërblime që nga viti 1978 e deri më tani, midis të cilave ai i veçonte:

Çmimi i parë për “Shtatoren e Nënë Terezës”, Prishtinë, në vitin 2000/ Çmimi i parë për “Skënderbeu, strateg dhe diplomat”, Prishtinë, (2004)/ Çmimi i parë për “Monumenti Nënë Tereza” Tiranë (2005)/ Çmimi i parë për “Shtatorja e Akademikut Fehmi Agani” Prishtinë, (2006)/ Çmimi i Parë për statueten Bekim Fehmiu Ministria e Kulturës (2014)/ Çmimi për shtatoren e Ismail Qemalit, Prishtinë (2015)/ Dhe në vitin 2020 – Çmimi i parë për skulpturë të Asociacionit të Artistëve Kosovarë.

Luan Mulliqi me entuziazmin dhe vullnetin që kishte për artin, realizojë shumë; ekspozita të krijuesve dhe artistëve figurativë vendor dhe krijuesve ndërkombëtar në hapësirat e ASHAK-ut, duke potencuar dhe nxit tema aktuale dhe duke dhënë mesazhe për krijuesit e rrije dhe shoqërinë.

Ai gjithashtu ka iniciuar që Akademia të krijoj një gamë të veprave artistike në pronësi të Akademisë, që me krenari i quante jo vetëm art, por kulturë dhe trashëgimi.

Ai jo vetëm që ishte profesor, artist dhe krijues i madh, por mbi të gjitha ai ishte njeri i afërte ,komunikues dhe shok i mirë me kolegët në stilin e një maestros.

Intelektual i formatit të veçantë me një energji krijuese, e bën Luan Mulliqin, një emër të veçantë e të paharruar të kulturës e artit publik ndër shqiptarët.

Zonja dhe Zotërinj,

Kjo trashëgimi e pasur krijuese që Akademik Mulliqi i ka lënë kulturës shqiptare në përgjithësi, është një kujtim i përjetshëm dhe ngushëllim i madh për familjen dhe të gjithë neve që sot nderojmë figurën e tij prej intelektualit e krijuesi.

Akademia me këtë komemoracion rasti në shenjë nderimi për emrin dhe veprën e Akademik Mulliqit, shpreh jo vetëm dhimbjen, por edhe falënderimin e mirënjohjen për thesarin e krijimtarisë artistike që na la.

Lavdi emrit dhe veprës së akademik Luan Mulliqi.

I përjetësohem kujtimi për te.